



Pranimi / Doretimi Pratipisje / Protokoll Received / Delivery	19-01	2	vit Year
Organ / Njësia Organi / Unitet Org / Unit	SKPM/SHCK	240/2022	113
Ref. Prot. Ref. Prot. Prot. No.			
Shënim / Prilog / Appendix			
Sasia Kopjime Quantity			



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1017/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji** për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1017/2021 të datës 07.12.2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Autoriteti i Aviacionit Civil, në çështjen juridike “kompensim material” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 18.01.2022, mori këtë:

### V E N D I M

**HEDHET** poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1017/2021 e datës 07.12.2021, e parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil, sipas akt emërimit të datës 10.01.2012 në pozitën “Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik të Aviacionit” pranë Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim të Aviacionit, me datën 31.05.2021 ka parashtruar kërkesën për pushim vjetor tek Udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë për ditët e mbetura të pushimit vjetor nga viti 2020 përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Me datën 07.06.2021 Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses i është përgjigjur tek kërkesa për pushim ankueses se “kërkohet angazhim gjatë kësaj periudhe në zbatimin e vendimit me numër 01/ZDP/VE/2021 të datës 19.01.2021” duke i’a refuzuar kërkesën për pushim vjetor.

Ankuesja përsëri me datën 16.06.2021 përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ka parashtruar kërkesën për pushim vjetor tek Udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë për 5 ditët e pa shfrytëzuara të viti 2020, por edhe këtë here Udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë me datën 17.06.2021 i’a ka refuzuar kërkesën për pushim ankueses.

Me datat 12.07.2021, 04.08.2021 dhe 11.08.2021 ankuesja përmes e-mailit zyrtar i drejtohet Menaxheres së Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil lidhur me kërkesën për kompensimin e pesë (5) ditëve të humbura të pushimit vjetor të vitit 2020 në vlerë monetare, pasi këto ditë i janë

refuzuar nga Udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë. Ndërsa me datën 11.08.2021, Menaxherja e Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil, i është përgjigjur ankueses përmes e-mailit zyrtar duke deklaruar se në praktiken e AAC-së humbja e pushimit për arsye të kryerjes së detyrave sipas përgjegjësisë, nuk është kompensuar me mjete-para po me rimbushim të ditëve të humbura andaj edhe ditët e humbura të pushimit do të kthehen ankueses në pushimin total siç kanë vepruar edhe me zyrtarët tjerë. Ankuesja po ashtu me kërkesë për kompensim në vlerë monetare lidhur me ditët e humbura të pushimit vjetor për vitin 2020 edhe gjatë muajit nëntor të viti 2021 i është drejtuar Udhëheqësit të saj të drejtpërdrejtë dhe Menaxheres së Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 14.12.2021, e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Autoritetin e Aviacionit Civil, ndërsa me datën 21.12.2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Autoriteti i Aviacionit Civil me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova:** Ankesën e ankueses me numër të protokollit 1017/2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 09.06.2021; E-mailin zyrtar të datës 07.06.2021; Kërkesën për pushim vjetor të ankueses e datës 31.05.2021; Kërkesën për pushim vjetor të ankueses e datës 16.06.2021; E-mailin zyrtar të datës 08.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 03.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 02.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 01.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 11.08.2021; E-mailin zyrtar të datës 11.08.2021; E-mailin zyrtar të datës 11.08.2021; E-mailin zyrtar të datës 12.06.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 14.12.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 21.12.2021; Akt emërimit e ankueses të datës 01.01.2012; Formularin PDP mbi përshkrimin e detyrave të punës së ankueses; Dosjen e pushimit vjetor për vitin 2021 të ankueses; Shkresën zyrtare mbi detajet e pushimit vjetor për ankuesen; Kërkesën për pushim mjekësor të ankueses e datës 13.01.2021 së bashku me aprovim nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë; Kërkesën për pushim vjetor të ankueses e datës 01.02.2021 së bashku me aprovim nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë; Kërkesën për pushim vjetor të ankueses e datës 01.04.2021 së bashku me aprovim nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses; Kërkesën për pushim vjetor të ankueses e datës 28.04.2021 së bashku me aprovim nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses; Kërkesën për pushim vjetor të ankueses e datës 19.05.2021 me aprovim nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë; Kërkesën për pushim vjetor të ankueses e datës 04.06.2021 së bashku me aprovim nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë; Kërkesën për pushim vjetor të ankueses e datës 14.06.2021 së bashku me refuzim nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë; Kërkesën për pushim vjetor të ankueses e datës 21.06.2021 së bashku me aprovim nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë; Kërkesën për pushim vjetor të ankueses e datës 21.06.2021 së bashku me refuzim nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë; Kërkesën për pushim vjetor të ankueses e datës 21.07.2021 së bashku me aprovim nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë; Kërkesën për pushim vjetor të ankueses e datës 13.09.2021 së bashku me aprovim nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë; Kërkesën për pushim vjetor të ankueses e datës 10.11.2021 së bashku me aprovim nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë; E-mailin e datës 09.11.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa lejuar,**  
**sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 paragrafi 1 përcakton se :

**“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve , nga data kur është njoftuar për aktin administrativ”.**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e bashkangjitura në lëndë të dërguara nga organi i punësisimit dhe nga ankuesja, ka konstatuar se ankuesja me datën 16.06.2021 përmes Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore- SIMBNJ, ka parashtruar kërkesën për aprovim të pushimit vjetor për 5 ditët e mbetura të vitit 2020. tek Udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë, të cilën kërkesë Udhëheqësi i saj me datën 17.06.2021, e ka refuzuar, ndërsa ankuesja ankesën me numër protokolli 5852/2021 e ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 07.12.2021, andaj Kolegji vlerëson se parashtrimi i ankesës nga ankuesja me datë 07.12.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: **“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ”.** Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesja Besnike Ukmata nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit për parashtrimin e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për refuzimin e kërkesës për pushim vjetor nga ana e Udhëheqësit të saj të drejtpërdrejtë, prandaj në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 te Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesa e ankueses është e pa lejuar.

Andaj, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda me numër A.nr.1017/2021**

Ardita Perçuku-Shyti

  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsorë GASHI-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

